



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 751/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues Burim Ademi dhe Fekri Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin nga Qendra Kulturore ORFEU me kryetar Gentrin Sylja, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

### V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.751/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Qendra Kulturore ORFEU me kryetar Gentrin Sylja, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: 1801E/04, 02R, 03R, 03D, 1808E/02D, 1815E/02D, 1820E/01R, 1824E/03R, 04R, 06R, 07R, 08R, 15D, 1827E/01R, 1833E/02D, 1834E/01R, 1836E/01D, 1830E/01R, 02D, 1802X/01R, 02R, 03R, 1804E/01R, 02D, 1805E/01D, 1806E/01D, 1807E/01R, 1807E/02R, 03D, 1814E/02R, 03D, 1821E/01D, 1822E/02D, 1817E/01R, 02D, 1825E/01D, 1827E/01R, 1828E/01D, 1839E/01R, 1840E/01D, 1841E/02D, 1844E/01D, 1842E/01D.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.751/2021 nga Qendra Kulturore ORFEU me kryetar Gentrin Sylja, me të cilën pretendon se organizata e tyre e cila e ka monitoruar procesin e votimit në të gjitha qendrat e votimit në Podujevë. Më tutje pretendojnë se gjatë procesit të numrimit dhe plotësimit të formularve monitoruesit e tyre kanë pasur qasje të kufizuara nga komisionarët. Më tutje pretendojnë se kjo u ka pamundësuar marrjen e saktë të informatave dhe rrjedhimisht ka ngjallur dyshimet për keqperdorimin e votave të kandidatëve brenda partiak. Andaj kërkojnë nga PZAP që të rinumërohen këto vendvotime: 1801E/04, 02R, 03R, 03D, 1808E/02D, 1815E/02D, 1820E/01R, 1824E/03R, 04R, 06R, 07R, 08R, 15D, 1827E/01R, 1833E/02D, 1834E/01R, 1836E/01D, 1830E/01R, 02D, 1802X/01R, 02R, 03R, 1804E/01R, 02D, 1805E/01D, 1806E/01D, 1807E/01R, 1807E/02R, 03D, 1814E/02R, 03D, 1821E/01D, 1822E/02D, 1817E/01R, 02D, 1825E/01D, 1827E/01R, 1828E/01D, 1839E/01R, 1840E/01D, 1841E/02D, 1844E/01D, 1842E/01D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Qendra Kulturore ORFEU me kryetar Gentrin Sylja, ka paraqitur apel Anr.751/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: 1801E/04, 02R, 03R, 03D, 1808E/02D, 1815E/02D, 1820E/01R, 1824E/03R, 04R, 06R, 07R, 08R, 15D, 1827E/01R, 1833E/02D, 1834E/01R, 1836E/01D, 1830E/01R, 02D, 1802X/01R, 02R, 03R, 1804E/01R, 02D, 1805E/01D, 1806E/01D, 1807E/01R, 1807E/02R, 03D, 1814E/02R, 03D, 1821E/01D, 1822E/02D, 1817E/01R, 02D, 1825E/01D, 1827E/01R, 1828E/01D, 1839E/01R, 1840E/01D, 1841E/02D, 1844E/01D, 1842E/01D.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.751/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Qendra Kulturore ORFEU me kryetar Gentrin Sylja, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, Më tutje pretendojnë se gjatë procesit të numërimit dhe plotësimit të formularëve monitoruesit e tyre kanë pasur qasje të kufizuar nga komisionarët. Më tutje pretendojnë se kjo u ka pamundësuar marrjen e saktë të informatave dhe rrjedhimisht ka ngjallur dyshimet për keqpërdorimin e votave të kandidatëve.

Në rastin konkret paneli vlerëson se një pretendim i tillë i përgjithësuar është tërësishëm i pa bazuar dhe i pa argumentuar, për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë dëshmi, qoftë ndonjë formular apo provë tjetër që do të bënte apelin të bazuar, andaj mbi një gjendje të tillë të fakteve paneli e refuzoi apelin në tërësi si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Qendra Kulturore ORFEU me kryetar Gentrin Sylja, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat dhe plotësimit të formularëve nga ana e komisionarëve.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr. 751/2021 më datën 06.03.2021**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.